

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



INVESTITOR: PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR “SHINY 1” SH.P.K.

TITULLI I PROJEKTIT: “Fabrikë për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura”

NGASTRAT KADASTRALE: P-71813046-02273-0 ME SIPËRFAQE S = 2000 m²

ZONA KADASTRALE: LUBIZHDË

KOMUNA: PRIZRENIT

Korrik 2025

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT	6
2.1. Rregullativa ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës	8
3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	9
3.1. Potencialet ekzistuese.....	10
3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit.....	11
3.3. Pozita gjeografike e lokacionit	12
3.4. Popullsia dhe vendbanimet.....	16
3.5. Lidhjet e Komunikacionit	16
3.6. Kushtet klimatike.....	17
3.7. Reshjet	17
3.8. Erërat.....	17
3.9. Hidrogjeologjia.....	18
3.10. Pedologjia	18
3.11. Natyra dhe biodiversiteti	19
3.12. Flora dhe Fauna	19
3.13. Dukshmëria	19
3.14. Ajri	20
3.15. Uji	20
3.16. Zhurma	20
3.18. Efektet vizuale (peizazhi)	21
4. 0. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA.....	21
4.1. Objektivat dhe infrastruktura	21
4.2. PROCESET QË KRYHEN NË KUADER TE KOMPLEKSIT TË KOMPANISË	
“SHINY 1” SHPK.....	23
4.4.2. Procesi teknologjik i prodhimit të detergjentëve	29
4.5. Produktet e pastrimit dhe preparatet për shkëlqim	30
4.5.1. Procesi teknologjik i prodhimit (i përgjithshëm).....	30
5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	32
5.1. Ndikimet në ajër	33

5.2. Ndikimet në tokë.....	33
5.3. Ndikimet në ujë	33
5.4. Ndikimet në Peisazh.....	34
5.5. Ndikimet në botën bimore	35
5.6. Ndikimet në popullatë	35
5.7. Ndikimet nga Zhurma.....	35
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	36
6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE	
37	
6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	37
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës dhe ujit	37
6.4. Masat për mbrojtje nga zhurma	39
6.7. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	40
6.8. Menaxhimi i mbeturinave.....	42
7.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT	42
8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	43
9.0 KONKLUCIONE DHE PËRFUNDIM	45
LITERATURA.....	46
Shtojcë.....	46

1. HYRJE

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është përgatitur për projektin “Fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura”, të Kompanisë “SHINY 1” SH.P.K.. Projekti parashihet të realizohet në zonën kadastrale Lubizhdë, komuna e Prizrenit, përkatësisht në ngastrën kadastrale më numër të njësisë kadastrale P-71813046-02273-0 me sipërfaqe 2000 m², gjithnjë sipas Certifikatës së pronësis me numër të lëndës 07-029-4598-25-Ç lëshuar me datë 29.05.2025 nga komuna e Prizrenit. Në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kërkesës së inspektoriatit është kërkuar të bëhet edhe hartimi i Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si kusht për lejimin e aktivitetit. Ky raport do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë të lokacionit ku do të realizohet projekti i lartëcekur.

Hartimi i këtij raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domosdoshëm për paisjen e kompanisë me Pëlqim Mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Qëllimi i hartimit të raportit është evidentimi i të gjitha kushteve përreth në lokacionin ku bëhen planifikimi për realizim të aktiviteve përkatëse, për faktin se në kohën moderne po bëhen intervenime të vazhdueshme në mjedisin natyror, duke ndikuar kështu në humbjen e balancës ekologjike natyrore. Bazuar në qëllimin paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t’u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Andaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t’a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme. Projekti në fjalë është një projekt shumë i rëndësishëm dhe i cili do të kontribuon në rritjen e prodhimit vendor me produkte cilësore të detergjenteve dhe pastrimit, gjithashtu ky aktivitet do të ndikoj edhe në fuqizimin ekonomik të vendit.

Raporti paraqet në mënyrë transparente ndikimin në mjedis të projektit mbi realizimin e aktivitetit të prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura së bashku me paisjet e tjera përcjellëse për realizimin e tij në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis për kompaninë “SHINY 1” Shpk, për fabrikën për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna Prizrenit është hartuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku parashihet, për t’u realizuar aktiviteti i lartëcekur.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-s kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjerë në kufijtë e lejuar.

Raporti është hartuar në bazë të informatave të siguruara nga Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, dhe nga literatura ekzistuese për zonën. Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti, vlenë të theksohet se në kohën kur po hartohet raporti objekti është i ndërtuar dhe është duke u zhvilluar aktiviteti.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Raporti i VNM-së përfshin indentifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjatë funksionimit të vazhdueshëm të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, atë:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis - VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për VNM (Nr. 08/L-181) ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo

menjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së për projektin “prodhimi i sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura”, janë shfrytëzuar ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Ligji Nr. 08/L-181
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/11 për rrugë
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të Mbeturinave.
- Udhëzimi administrativ (QRK) Nr. 03/2021 për Menaxhimin e mbeturinave të Rrezikshme.
- Udhëzimi adminstrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë.
- Udhëzimi Administrativ (QRT) Nr. 07/2021 për rregulloret dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.

b) Dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos eksperiencës profesionale në udhëheqjen e procesit gjatë funksionimit të vazhdueshëm të Fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin aktivitetet në fabrikën:

- Projekti i ndërtimit
- Procesi teknologjik që zhvillohet në këtë fabrikë
- Qertifikata e biznesit,
- Qertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme,
- Kopja e planit të parcelës,
- Situacioni i terenit,

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-së, si dhe Direktiva për mbeturinat.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për fabrikën për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku parashihet të zhvillohet aktiviteti i fabrikës për prodhimin e detergjentëve.
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.

- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është planifikuar për zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik.

Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

d) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe nga hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjërë të fabrikës së prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.




Fig. 2. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1 është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të fabrikës së prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në hapësirën e lartëcekur.

3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit

Investitori për realizimin e aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatës të lejeve të nevojshme për lejimin e operimit fabrikës së prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Pronësia e ngastrave për ndërtimin e kësaj fabrikë është pronë private në emrin e Biznesit “SHINY 1” shpk nga Prizreni me pronar Adnan Bylybi. Sipërfaqja dhe objekti kanë këto të dhëna urbanistike:

- **Sipërfaqëja e ngastrës:**
- **P-71813046-00515-0** me sipërfaqe **S = 2000 m²**
- Numri maksimal i etazhitetit është **P+0**
- Sipërfaqja e ndërtimit të objektit në përdhese **S = 904 m²**



Fig. 3. Situacioni i ngushtë i lokacionit ku është vendosur fabrika

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit



Lokacioni ku është planifikuar zhvillimi i aktivitetit të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, gjendet në njësinë kadastrale P-71813046-02273-0 me sipërfaqe $S = 2000 \text{ m}^2$, në vendin e quajtur BOGOSHEVICA, zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Ky projekt ka destinim prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në ngastrën me sipërfaqen e lartëcekuar me formë të rregullt gjeometrike, ku dhe mund të verifikohet në bazë të fletave poseduese dhe kopjes së planit të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit, poashtu me anë të këtyre dokumenteve është dëshmuar e drejta pronësore – juridike e cila është në emër të parashtruesit të kërkesës të “SHINY 1” SHPK.

Lokacioni ku është planifikuar zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, gjenden në anën e majtë të rrugës magjistrale Prizren - Suharekë, përkatësisht në zonën kadastrale Lubizhdë, në kilometrin e dytë të kësaj rruge. Pozita e paraparë për zhvillim të aktivitetit të lartëcekur është mjaft e volitshme, me një infrastrukturë të pajisur teknike për kyqje në kanalizim, rryme dhe ujësjellës, ka një mundësi mjaft të mirë, objektet kanë pamjen Jug – Përendim, dhe do të shërbejnë për nevojat e fabrikës. Destinimi i këtyre objekteve parashihet të jetë fabrikë ku zhvillohet aktiviteti i prodhimit dhe në pjesën tjetër depo për magazinimin dhe deponim të produkteve.

Në këtë lokacion të afërt nuk ka të ndërtuara shtëpi të banimit, por ka objekte afariste tjera me veprimtari të ngjashme apo të ndryshme si restorante, salla të dasmave, ndërsa në një distancë më të largët zhvillohen biznese të ndryshme prodhuese dhe jo prodhuese. Toka e këtij lokaliteti i përket llojit të shfrytëzimit si tokë Bujqësore, shfrytëzimi aktual Arat, kualiteti i tokës Arë e klasës 4.

Realizimi i aktivitetit të prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në këtë lokalitet kanë një pozitë të mirë për të realizuar aktivitetin në fjalë, pasi që nuk ka afër shtëpi të banimi, nuk paraqet pengesë për banorët e asaj ane, e as për komunën e Prizrenit, ndërsa sa i përket lidhjes infrastrukture përmes rrugës magjistrale dhe tranzitit të Ri kyqet në magjistralen Prizren – Suharekë, ndërsa në pjesën perëndimore tranziti i Ri ka qasje në magjistralen Prizren – Gjakovë si dhe shumë afër ndodhet kyqja në Autostradën “Ibrahim Rugova”. Fabrika përmes rrugës dytësore ka kyçjen në rrugë kryesore Prizren - Suharekë duke mos pasur pengesa për të tjerët.

3.2. Pozita Gjeografike






Fig. 3. Pamja satelitore e lokacionit të projektit





Foto 4. Pamje nga fabrika për prodhimin e detergjenteve

Zona ku ndodhet fabrika për prodhimin të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, shtrihet në pjesën veri - lindore nga qendra e Qytetit i Prizrenit gjegjësisht në kilometrin e 2-dytë përgjatë rrugës magjistrale e cila lidhë Prizrenin me Suharekën, ndërsa ngastra ka qasje në anën lindore në magjistrale Prizren–Suharekë. Fabrika do të jetë i karakterit prodhues, afarist dhe depo me sipërfaqe të mjaftueshme për zhvillimin e këtij lloji të aktivitetit gjithashtu do të jenë të organizuara njësit sipas kërkesës dhe nevojës së investitorit do të shfrytëzohen për administratë.

Rrugët me të cilat kufizohet lokacioni i fabrikës nuk janë të asfaltuara, por i plotësojnë në tërësi kriteret për funksionim normal të fabrikës dhe transportimit.

Vlenë të theksohet që në kohën kur është hartuar Raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, objektet janë ndërtuar dhe realizohet aktiviti në ngastëren e lartëcekur.

Në territorin e analizuar dhe më gjerë, klima ka të bëjë me ndikimet e brezeve klimatike Evropiane subtropikale të matura, mes rajoneve mesdhetare kontinentale edhe atyre kontinentale-europiane. Klima mesdhetare kontinentale është e njohur sipas sasive më të mëdha të reshjeve në periudhat dimërore, kurse verës ky rajon është nën ndikimin e ciklonit azotik me masa ajrore me prejardhje tropikale, që ka si pasojë vera të nxehta dhe të thata. Në rajonin kontinental evropian janë të theksuara – dominojnë reshjet e mëdha në muajt e pranverës dhe verës në raport me ata të dimrit, sipas të dhënave të IHMK.

3.4. Popullsia dhe vendbanimet

Kur është në pyetje raporti i VNM-së, ndër veçoritë kryesore të analizuara janë edhe popullata, zhvillimet demografike si dhe vendbanimet. Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % të territorit të Kosovës) posedon 76 vendbanime me 220.776 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000 banorë.

Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit në bazë të modelit të Austrisë, Sllovenisë, Zvicrës. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve janë, ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Lokacioni i planifikuar për realizimin e aktivitetit të fabrikës së prodhimit të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura ndodhet në pjesën veri - lindore nga qendra e Qytetit i Prizrenit gjegjësisht në kilometrin e 2-dytë përgjatë rrugës magjistrale e cila lidhë Prizren me Suharekën, në afërsi të lokacionit nuk është konstatuar ndonjë objekt banimi përkatësisht vendbanim i populluar, por zona kryesisht konsiderohet të jetë zonë bujqësore dhe toka bujqësore me destinim bujqësin, si dhe zonë e industrializuar me një munër të madhe të bizneseve.

3.5. Lidhjet e Komunikacionit

Sa i përket infrastrukturës rrugore Prizreni ka lidhje shumë të mira të komunikimit rrugor me qendrat tjera në Kosovës dhe rajonit. Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Pranë lokacionit të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si

dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, kalon rruga regjionale Prizren – Suharekë – Prishtinë, e cila përmes Tranzitit të Ri lidhet me autostradën Prishtinë – Tiranë. Kjo lidhje e mirë e komunikacionit rrugor i mundëson kompanisë të ketë vlerën ekonomike për tregun vendor por edhe atë ndërkombëtar. Furnizimi me energji elektrike bëhet përmes rrjetit elektrik dhe trafos private me kapacitete 250 kW.

3.6. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulëta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën Juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasi të bores me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej - 0.5°C.

3.7. Reshjet

Regjimi i reshjeve në komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri në 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %. Reshjet janë element apo faktorë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e hidroekonomisë, duke përfshirë debitin e ujërave nëntokësor.

3.8. Erërat

Në lokacionin e fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore. Me intensitet më të madhe të shpejtësisë

paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat përendimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226% dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27%, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.9. Hidrogeologjia

Në pjesën e ngastrës ku realizohet ky projekt ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin Bistrica e Prizrenit dhe më tutje në afërsi derdhet në lumin Drini i Bardhë, që njëherit paraqet edhe ujëmbledhësin kryesor në këtë rajon. Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Bistrica dhe Drini i Bardhë, por në bazë të shpimeve të puseve që janë bërë nga komuniteti për nevoja personale dhe informatave të marrura nga ta, thellësitë e ujërave nëntokësore janë mesatare. Ujërat e lumit Bistrica e Prizrenit dhe të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij.

Rrjedhat e lumenjëve nuk i rrezikojnë vendbanimet sepse ato deri më tani nuk kanë dalur nga shtrati i tyre, ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferik. Ndërsa tek zona në studim nuk kemi hasur në ujëra sipërfaqësore në formë të lumit apo liqeneve, por ujerat sipërfaqësore mund të grumbullohen vetëm gjatë dimrit pas reshjeve të mëdha atmosferike.

3.10. Pedologjia

Tereni përreth lokacionit të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit është kryesisht tokë bujqësore, ndërsa toka e ngastrës në fjalë i përket llojit të shfrytëzimit si tokë Bujqësore, shfrytëzimi aktual Arat, kualiteti i tokës Arë e klasës 4, sipërfaqet janë të mbuluara nga tokat aluviale, deluviale janë toka me rentabilitet të lartë të kultivimit të kulturave bujqësore. Hapësira të rrafshëta më formacione të ndryshme të shkurreve dhe bimë të ulta barishtore që i takonjë familjeve të ndryshme karakteristike për toka të tilla.

3.11. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje.

3.12. Flora dhe Fauna

Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive që kanë filluar si pasojë veprimtarisë së njeriut, kryesisht për zhvillim industrial të kësaj ane. Në rrethin të ngushtë të lokacionit flora dhe fauna janë shumë të zhvilluara. Në sipërfaqet në regjionin më të gjërë posaçërisht në ato që ekzistojnë në ultësinë ekzistojnë sipërfaqet e tokave livadhor, andaj edhe karakteristike janë llojet bimore të përshtatshme për livadhe, poashtu dhe kultura të ndryshme bujqesore të kultivuara nga ana e bujqëve të rrethnës. Mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku do të realizohet aktiviteti nuk kemi hasur në bimësi që karakterizohen me vlera reprezentative kryesisht nga bimët e ulta barishtore. Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionimin e fabrikës për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit më të gjerë, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në zonën më të largët nga lokacioni jetojnë gjitarët, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllënëza e fushës, sorra, etj.

3.13. Dukshmëria

Shikuar nga pozita, ku ndodhet fabrika për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, dukshmëria është mjaft e lartë e posaçërisht kah ana jug-perëndimore dhe jug-lindore e cila mund të mbërrijë 5-7 km.

3.14. Ajri

Ndotja e ajrit në qytetin e Prizrenit dhe në rrethinë të tij është evidente, kjo argumentohet nga matjet që realizohen nga institucionet kompetente. Ndotja e ajrit vjen si pasojë e shkarkimeve industriale, nga aktivitete urbane, ku veçohet trafiku i automjeteve (të vjetruara) të shumta në komunikacion të dendur, sidomos nga autostrada dhe rrugët tjera urbane dhe magjistrale, ngrohja e ekonomive familjare me lëndë djegëse thengjill dhe dru gjatë stinës së dimrit, etj.

Nga vetë konfiguracioni i terrenit dhe funksionimi i aktiviteteve industriale, nga objektet industriale ekzistuese të mëhershme, mund të konkludojmë se ndotja e ajrit në këtë region është e pranishme. Gjithashtu frekuenca e madhe e automjeteve në rrugë ndikojnë në ndotjen e ajrit, edhe objektet me aktivitete industriale të cilat kanë filluar të ndërtohen ndikojnë në ndotjen e ajrit.

3.15. Uji

Siç e kemi cek edhe më parë, në këtë rajon nuk kemi hasur në ndonjë rrjedhë ujore të tipit të lumenjëve apo ndonjë liqeni. Ato pak që krijohen mund të jenë kryesisht nga reshjet atmosferike kryesisht në kohë të dimrit. Në përgjithësi ujrë në lokacione të tilla të përafërta për skaj rrugës mund të ndoten edhe nga trafiku që zhvillohet për gjatë rrugës poashtu edhe nga shpërlarja e të reshurave atmosferike. Ujin për nevojë të fabrikës kompania e ka zgjedhur duke e hapur pusin personal.

3.16. Zhurma

Në lokacionin e analizuar dhe më gjerë nuk kemi ndonjë matje të zhurmës, zhurma që do të krijohet në fabrikën për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, me infrastrukture përcjellëse, shkaktohet nga frekuenca e automjeteve tjera motorike që lëvizin në rrugët automobilistike por ato mund të konsiderohen se janë edhe të pa përfillshme.

Mund të konstatojmë se fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, nuk gjeneron ndonjë zhurmë të përhershme që do të ndikonte në psikikën dhe koncentrimin njeriut në punë dhe rrethinë.

3.18. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleks i fabrikës për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura – mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Andaj pritet nga kompania që të punoj në harmoni me natyrën dhe të mos ndikoj në aspekt negative në pamjen vizuale të zonës ku bëhen planifikime për zhvillimin e aktiviteteve të fabrikës për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim.

4. 0. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA

4.1. Objektivat dhe infrastruktura

Përshkrimi i saktë i fabrikës për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në ngastërat P-71813046-02273-0 me sipërfaqe 2000 m² në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, ka dy objekte të cilët janë të ndarë sipas nevojës së shfrytëzimit dhe zë një sipërfaqe në total prej 904 m², objektet janë të ndarë si në vijim: Objekti i Administratës, hyrja e punëtorëve; Zyrat e stafit dhe menaxherit; Hapësira e stanzave; hapësira për prodhimin e detergjentëve dhe hapësira për deponim dhe ruajtje, impianti për trajtimin e ujit dhe vensojen e lëndës së parë.



Fig. 4. Objekti i fabrikës së kompanisë SHINY 1 shpk

Objekti i lartëcekur është ndërtuar nga konstruksioni i çelikut i kombinuar me konstruksion të betonit të armuar me dimensione dhe aftësi mbajtëse të parapara për mbajtjen e ngarkesave punuese. Hapësirat e mureve janë të mbyllura me blloka të argjilta dhe pastaj të suvatuar me termoizolime përkatëse dhe në disa pjesë më sandwich panel, kulmi është i mbuluar me sandwich panel me trashësi 12 cm.

Pershkrimi Teknik - Objektet e lartëpermendura kanë etazhitet P+0. Sistemi konstruktiv i objekteve është sistem i konstruksionit metalik i përbërë nga ramat metalik me profile të plota të cilet mbulojnë hapësirën $l=15.00$ m' dhe kanë lartësinë $H1 = 6$ m; Raster i mbajtesve kryesore (ramave) është 5.00 m, muret e jashtme, brendshme si dhe mbulesat e kulmit janë nga panelet sandwich $d= 12$ cm, të cilat vendosen, perforcohen në konstruksionet sekondare siç janë ato horizontale, vertikale dhe brinaket e kulmit. Fondimi i objektit është me themele të veçuara të lidhura ndërmjet veti me traje shtangues.

4.2. PROCESET QË KRYHEN NË KUADER TE KOMPLEKSIT TË KOMPANISË “SHINY 1” SHPK

Në kompleksin e kompanisë “SHINY 1” shpk në fabrikën për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim, posedojnë hapësirat si në vijim:

- Hapësirën me zyrën për personelin dhe për punëtorët ndihmës,
- Hapësirën për ushqim dhe nyjet sanitare,
- Hapësirat për pranimin të lëndës së parë,
- Hapësirat për prodhimin e detergjentëve,
- Hapësirat/depo për vendosjen e produkteve të prodhuara dhe paketuara,
- Rezervar/bure, 4 copë me kapacitet prej 5000 litër, 2 copë me kapacitet 2000 litra, 2 copë me kapacitet 1000 litër dhe 1 rezervuar për trajtimin e ujit me kapacitet 10.000 litra,
- Pajisja për përzierjen (kompozimin) e detergjentit, prodhim Turk,
- Pajisjet (makinat) për mbushjen e detergjenteve të lëngshme, prodhim Turk,
- Pajisjet (makinat) për vendosjen e etiketave, prodhuesi Turk,
- Pajisje për vendosjen e kapakëve prodhuesi Turk,

4.3. Produktet e prodhuara nga Kompania “SHINY 1” SH.P.K

Kompania “SHINY 1” SH.P.K fabrikë që merret me prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, me një kapacitet deri 5000 litra në ditë. Të gjitha llojet e produkteve të detergjenteve realizohet në bazë të kërkesave.

Llojet e detergjenteve që prodhohen janë:

- Detergjente për pastrimin e dyshemesë;
- Sapunë të lëngët për pastrimin e duarve;
- Shampon për flokë;
- Detergjente për pastrimin e enëve;
- Detergjente për pastrimin e xhamave;
- Detergjente për zbutjen e rrobave;
- Aromatizues për ambiente;
- Detergjente për larjen e rrobave;
- Detergjente për pastrimin e banjës dhe kuzhinës;

Në vijim do të paraqiten disa foto nga produktet që prodhohen:









4.4. Procesi teknologjik i prodhimit sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura

Sapunet janë produkte thelbësore të higjienës dhe pastrimit. Ato përgatiten nga vajrat ose yndyrat përmes saponifikimit dhe përdoren sepse mund të lidhin yndyrën me ujin, duke larguar papastërtitë më lehtë se uji i pastër. Kjo i bën ato ndër produktet më të vjetra dhe më të rëndësishme në jetën e përditshme të njeriut. Ndërsa detergjentët janë substanca sintetike që pastrojnë si sapunet, por janë më efektive në ujë të fortë dhe kanë përdorim më të gjerë. Ata përgatiten duke përzier surfaktantët me ujë dhe aditivë të ndryshëm në proces të kontrolluar teknologjik, për të prodhuar detergjentë për rroba, enë, trup, dyshe dhe aplikime industriale, kurse produktet e pastrimit janë formulime kimike që pastrojnë dhe largojnë papastërtitë, ndërsa preparatet për shkëlqim janë produkte që i japin sipërfaqes pamje të ndritshme dhe e mbrojnë nga njollat dhe pluhuri. Të dyja janë pjesë e rëndësishme e higjienës dhe mirëmbajtjes në jetën e përditshme dhe industri.

Në vijim do të paraqesim procesin teknologjik të prodhimit sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, në kompaninë “SHINY 1” Shpk në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit.

4.4.1. Procesi teknologjik i prodhimit të sapunit të lëngshëm (me KOH)

Fazat:

1. Përgatitja e lëndëve të para


- **Yndyrna/vajra bimore ose shtazore** (vaj kokosi, vaj ulliri, vaj palmë)
- **KOH (hidroksid kaliumi)**
- **Ujë për tretje.**

2. Tretja e KOH

- Hidroksidi i kaliumit tretet plotësisht në ujë për të formuar një tretësirë alkaline të fortë.

3. Ngrohja dhe saponifikimi

- Vajrat vendosen në reaktor.
- Shtohet tretësira e KOH gradualisht.
- Ngrohja në **70-80°C**, me përzierje të vazhdueshme deri sa reaksioni të përfundojë (2-4 orë).
- Procesi ndodh sipas reaksionit:



4. Kontrolli i përfundimit të reaksionit

- Kontrollohet që nuk ka më yndyrë të patretur (prova me indikator fenolftaleinë ose titrim).

5. Rregullimi i pH

- pH duhet të jetë **8-10** (të jetë alkaline por jo irritues).

6. Përzierja me përbërës shtesë

- Ngjyrues ujorë
- Parfum/aroma
- Preservativë (p.sh. Phenoxyethanol + Ethylhexylglycerin)
- Chelantë (EDTA) për stabilitet të ngjyrës dhe viskozitetit.

7. Homogjenizimi

- Përzierje e butë për të shmangur formimin e shkumës së tepërt.

8. Filtrimi (nëse nevojitet)

- Për të hequr ndonjë grimcë të patretur.

9. Ambalazhimi

- Në shishe PET/HDPE, me pompë dozimi.

4.4.2. Procesi teknologjik i prodhimit të detergjentëve

1. Furnizimi me surfaktantit aktiv

- Furnizimi direkt nga prodhuesit kimikë.

2. Përgatitja e tretësirës bazë

- Ujë i demineralizuar si bazë.

3. Shtimi i surfaktantëve të tjerë

- Anionikë, jo-jonikë, amfotere, sipas formulës.

4. Shtimi i aditivëve

- Chelantë (EDTA), enzima (p.sh. proteaza), stabilizues, përmirësues shkumë.

5. Shtimi i ngjyruesve dhe aromave

- Për pamje dhe aromë tregtare.

6. Rregullimi i pH

- Me acid ose bazë, sipas kërkesave të produktit.

7. Homogjenizimi

- Përzierje intensive për tretje dhe shpërndarje të plotë.

8. Filtrimi (nëse kërkohet)

- Për të larguar grimcat e papërziera.

9. Ambalazhimi


- Në shishe plastike, etiketimi dhe paketimi.

4.5. Produktet e pastrimit dhe preparatet për shkëlqim

Produktet e pastrimit janë preparate kimike të formuluar për të larguar papastërtitë, yndyrat, njollat dhe mikrobet nga sipërfaqe të ndryshme, ndërsa preparatet për shkëlqim (shine agents, polish) janë produkte të veçanta që i japin shkëlqim dhe pamje të pastër sipërfaqeve, si pllaka, xhama, metal, mobilie. Formojnë një shtresë të hollë mbrojtëse, duke parandaluar njollat e shpejta ose mbledhjen e pluhurit.

4.5.1. Procesi teknologjik i prodhimit (i përgjithshëm)

1. Përgatitja e ujit të demineralizuar
2. Tretja e surfaktantëve ose polimereve silikone
3. Shtimi i alkoolit ose tretësve organikë (për preparatet për shkëlqim)
4. Shtimi i aditivëve dhe chelantëve (për produktet e pastrimit)
5. Shtimi i ngjyresve dhe aromave
6. Homogjenizimi i plotë i përzierjes
7. Kontrolli i pH
8. Filtrimi (nëse kërkohet)
9. Ambalazhimi dhe etiketimi.



4.5.2. Përgatitja e pallomave

- Pallomat blihen të gatshme në role të mëdha industriale.
- Rola vendoset në makinerinë automatike ku:
- Priten sipas dimensionit të kërkuar (p.sh. 15x20 cm ose sipas specifikimit të produktit)
- Numërohen automatikisht sipas paketimit të planifikuar

Paletizimi dhe magazinimi

- Paketat finalizohen në kartona transportues dhe vendosen në paleta.
- Ruajtja bëhet në ambient të pastër, me temperatura të kontrolluara sipas specifikimeve të produktit





4.6. Lëndet ndihmese që shfrytëzohen për zhvillimin e aktivitetit nga kompania

Kompania për ta zhvilluar aktivitetin e vete përdorë këto lëndë:

1. Uji – kompania ka të hapur pusin për furnizim me ujë, gjithashtu është e lidhur me rrjetin e ujësjellsit.
2. Kompania me energji elektrike furnizohet nga rrjeti i KEDS dhe Kes-Co, përmes trafos personale 250 KW.
3. Ndërsa substancat/preparatet kimike të cilat i përdorë për prodhimin e sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim i merr nga operator ekonomik të licencuar për shitjen e tyre.
4. Kompania produktet e prodhuara i tregton/shet në Kosovë dhe vendet e ndryshme të Evropës.

5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve teknologjike që kryhen në kompaninë „SHINY 1” SH.P.K., në zonë kadastrale Lubizhdë, komuna Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithë përfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Gjatë procesit të marrjes së pëlqimi mjedisor po bëhet ky raport për të paraqitur disa nga fazat e mundshme të efekteve negative që paraqiten në mjedisin jetësor dhe atë gjatë fazës së operimit të aktivitetit do të ketë prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për

shkëlqim si dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, gjatë funksionimit të saj dhe pas përfundimit të procesit në mënyrë që të paraqiten të dhëna për ndikimet eventuale dhe të mundshme që vijnë nga aktiviteti i projektit në fjalë.

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet për fazën e zhvillimit të aktiviteteve nga Kompania “SHINY 1” Sh.p.k. e cila si aktivitet ka prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, gjithashtu duhet paraparë ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të aktivitetit.

5.1. Ndikimet në ajër

Ndotja e ajrit në këtë lokacion mund të paraqitet në masë të vogël gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit. Megjithatë, duke marrë parasysh vendndodhjen e ngastrës ku ndodhet fabrika, e cila është afër rrugës magjistrale dhe autostradës me frekuencë të lartë të trafikut, ndotja që vjen nga këto mjete është e papërfillshme në raport me trafikun ekzistues.

Me rëndësi mbetet që kompania të ketë kujdes në minimizimin e gjenerimit të ndotjes gjatë zhvillimit të veprimtarisë, pasi aktiviteti i saj do të jetë afatgjatë.

Gjatë funksionimit të rregullt të fabrikës për prodhimin e detergjentëve dhe sapunëve të lëngshëm, nuk pritet të ketë ndotje të konsiderueshme të ajrit. Nuk parashikohen përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në zonën përreth fabrikës. Përgjatë mund të bëjnë pluhurat, të cilët mund të krijohen nga:

- Automjetet e transportit, gjatë lëvizjes në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të fabrikës;
- Proceset e ngarkimit dhe shkarkimit të lëndës së parë dhe produkteve finale.

Gjithashtu, ndotje minimale e ajrit mund të paraqitet gjatë sezonit të dimrit, për shkak të gazrave të liruara nga djegia e lëndëve djegëse të përdorura për ngrohjen e objekteve.

Brenda fabrikës, ajri mund të ndotet edhe nga avujt e substancave kimike, veçanërisht acidet dhe bazat e forta të përdorura në proceset teknologjike.

5.2. Ndikimet në tokë

Aktivitetet që zhvillohen në këtë fabrikë nuk pritet të kenë ndikim të madh në tokë, përveç ndikimeve të krijuara gjatë fazës së ndërtimit të objektit. Jashtë ngastrës së kompanisë, nuk

parashihen ndikime në tokë, pasi nuk do të ketë ndonjë aktivitet që mund të shkaktojë presion ose trysni anësore në zonat përreth.

Ujërat që nevojiten për qëllime sanitare dhe larjen e hapësirave të fabrikës mblidhen në kanalet drenazhuese të brendshme dhe më pas shkarkohen në rrjetin e kanalizimit. Duke marrë parasysh natyrën e procesit teknologjik, nuk parashihen krijime të ujërave të ndotura industriale, përveç:

- Ujërave të larjes së bureve dhe sistemit të mbushjes,
- Si dhe ujërave të zeza sanitare që krijohen nga punonjësit.

Nga shkarkimi i ujërave pas procesit të prodhimit nuk pritet ndotje e tokës, pasi kompania “SHINY 1” Sh.p.k. i trajton ujërat në gropën septike të ndërtuar në hapësirën e fabrikës, edhe pse ajo ka nevojë të rinovohet apo rindërtohet, për të përmbushur standardet e nevojshme teknike dhe mjedisore.

Ndërsa, ndikime të tjera si derdhja e vajrave të makinerive apo derdhje aksidentale të substancave kimike nuk priten, pasi kompania ka ndërmarrë të gjitha masat teknike dhe operative për parandalimin e ndotjeve të mundshme të tokës.

5.3. Ndikimet në ujë

Në afërsi të kësaj fabrike nuk është evidentuar ndonjë rrjedhë ujore sipërfaqësore që do të mund të ndikohej drejtpërdrejt nga aktivitetet e saj. Megjithatë, ndotja e ujërave mund të paraqitet nëse ujërat e krijuara nga proceset e pastrimit dhe larjes shkarkohen pa trajtim adekuat, duke rrezikuar ujërat sipërfaqësore ose ato nëntokësore.

Gjatë operimeve, cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të ndikohet në këto mënyra:

- Menaxhimi jo adekuat i ujërave të zeza sanitare, i cili mund të rezultojë me depërtimin e ndotjeve në ujërat nëntokësore;
- Menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave industriale, që përfshin ujërat e larjes së pajisjeve dhe hapësirave të prodhimit;
- Menaxhimi jo adekuat i substancave kimike, të cilat përdoren si lëndë e parë për prodhimin e detergjentëve dhe sapunëve dhe që mund të paraqesin rrezik potencial për ndotjen e ujërave në rast të derdhjeve aksidentale ose ruajtjes jo të sigurt.

5.4. Ndikimet në Peisazh

Duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit, formën dhe vendosjen e fabrikës, si dhe distancën e konsiderueshme nga zonat e banuara, mund të konkludohet se kjo zonë është e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të tilla. Ndërtimi i fabrikës nuk paraqet ndikim vizual të theksuar apo pamje të vrazhdë për syrin e njeriut.

Bazuar në këto të dhëna, vlerësohet se aktiviteti i fabrikës dhe objektet e saj së bashku me infrastrukturën përkatëse nuk do të kenë ndikime negative në peizazhin e zonës.

5.5. Ndikimet në botën bimore dhe shtazore

Në lokacionin ku është ndërtuar fabrika për prodhimin e detergjentëve, bota bimore në sipërfaqen ndërtimore dhe manipuluese është dëmtuar dhe zhdukur si pasojë e ndërtimit të objektit dhe infrastrukturës përcjellëse. Ndërkaq, në zonën më të gjerë, veçanërisht në pjesën jugperëndimore, bota bimore është e zhvilluar mirë, e përbërë kryesisht nga bimë barishtore dhe shkurre tipike për këtë lokalitet bujqësor, ku toka klasifikohet si Arë e klasës IV, me shfrytëzim aktual për bujqësi (Arë).

Gjithashtu, në këtë lokacion dhe në zonën përreth nuk është evidentuar asnjë habitat i veçantë apo ndonjë lloj i mbrojtur i florës dhe faunës.

Rekomandohet që sipërfaqet e lira përreth fabrikës të gjelbërohen me bimësi dekorative dhe drunj ornamental, me qëllim të përmirësimit të pamjes vizuale dhe mikroklimës lokale.

Bazuar në analizat e kryera, konkludohet se aktiviteti i fabrikës nuk do të ketë ndikime të drejtpërdrejta apo të rëndësishme mbi florën dhe faunën e zones.

5.6. Ndikimet në popullatë

Lokacioni ku gjendet fabrika e lartpërmendur nuk ka ndikime negative në popullatën e zonës përreth. Fabrika e kompanisë “SHINY 1” Sh.p.k. është e vendosur në periferi, në pjesën veriore të Prizrenit, në zonën kadastrale Lubizhdë, dhe si e tillë nuk krijon shqetësime për banorët lokalë.

Kjo zonë tashmë është shndërruar në zonë industriale, ku operojnë një numër i madh biznesesh me veprimtari të ndryshme ekonomike. Përkundrazi, veprimtaria e fabrikës ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës, duke kontribuar në punësimin e komunitetit lokal. Aktualisht, në këtë fabrikë janë të punësuar 8 punëtorë me kontrata të përhershme.

Gjithashtu, fabrika ndihmon në furnizimin e tregut vendor dhe atij më të gjerë me produkte vendore dhe cilësore të detergjenteve, duke rritur konkurrueshmërinë e prodhimeve vendore në tregun e Kosovës dhe rajon.

5.7. Ndikimet nga Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit, zhurma paraqet një faktor me rëndësi të veçantë, pasi ndikon negativisht në shëndetin e njeriut, duke shkaktuar dëmtime të të dëgjuarit, çrregullime në sistemin nervor, hipertension, si dhe vështirësi në koncentrim gjatë punës.

Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e veprimtarisë që zhvillohet në këtë fabrikë, nuk pritët të ketë ndikim të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të zhurmës në ambientin përreth, i cili do të mund të shqetësonte banorët lokalë. Fabrika operon vetëm me një ndërrim të rregullt prej 8 orësh, gjatë orarit ditor, çka është favorshme në aspektin e ndikimit të zhurmës, pasi gjatë këtij orari pjesa më e madhe e qytetarëve janë aktivë dhe zhurma perceptohet më pak.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli	59	45	39	25
Për pajisje moderne				

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për bartjen e lëndës së parë dhe produkteve, si dhe duke pasur parasysh se fabrika punën do ta kryej në hapësira të mbyllura, mund të konkludojmë se kjo fabrikë në aspektin e zhurmës nuk do të ketë ndikime negative të mëdha në aktivitetet tjera që veprojnë në këtë lokalitet.

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet që mund të ndodhin në fabrikë janë të natyrave të ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë, megjithatë vlerësohen si raste të izoluara gjatë aktiviteteve të saj të përditshme.

Një nga aksidentet më të mundshme është zjarri. Sa i përket rrezikut nga zjarri, mund të konstatohet se ekziston një mundësi reale, por nuk do të bëhet analizë e detajuar e vlerësimit të rrezikut nga zjarri, pasi për këtë ekziston projekti (elaborati) kundër zjarrit dhe dokumentacioni për mbrojtje nga zjarri, i cili përfshin të gjitha masat preventive që duhet të ndërmerren në rast aksidenti zjarri.

Nëse rregullorja e punës së fabrikës së detergjentëve përmban në detaje të gjitha aktivitetet dhe veprimet për parandalimin e aksidenteve, atëherë mund të konstatohet se nuk do të ketë ndikime të mëdha aksidentale që do të rrezikojnë mjedisin.

Në pajtim me nenet e rregullores mbi metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë nga aksidenti kimik dhe ndotja e mjedisit, analiza e rrezikut bëhet në tri faza:

1. Identifikimi i rrezikut – përfshin mbledhjen e të dhënave mbi substancat e rrezikshme në proces, si dhe verifikimin e pikave kritike të procesit dhe stabilimenteve.
2. Analiza e pasojave – vlerësimi i ndikimeve të mundshme në rast aksidenti.
3. Vlerësimi i rrezikut – përgatitja e masave parandaluese dhe planifikimi i përgjigjes emergjente.

Pra, si përfundim, duke marrë parasysh natyrën e punës në këtë fabrikë, punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të trajnuar për substancat dhe komponimet kimike me të cilat punojnë, duke respektuar masat e sigurisë dhe procedurat operacionale në mënyrë që të minimizohen rreziqet aksidentale.

6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në komponentet e mjedisit si; ajër, tokë, ujë si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve për prodhim të sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura, duhet të merren masat që do të shkruhen në vijim:

6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, operatori ekonomik duhet të ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Mirëmbajtja dhe ujitja e vazhdueshme e sipërfaqeve të tokës ku zhvillohet aktiviteti, në mënyrë që të shmangët krijimi i pluhurit.
- Kujdes i veçantë ndaj pajisjeve dhe makinerive të transportit, për të siguruar që ato të jenë në gjendje teknike të rregullt dhe të mos lirojnë gazra ndotës në atmosferë. Gjithashtu, nuk duhet të mbahen ndezur pa nevojë, për të shmangur ndotjen e panevojshme të ajrit.

Nga procesi i prodhimit të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, ndotja e ajrit vlerësohet të jetë minimale, duke marrë parasysh natyrën e proceseve teknologjike që zhvillohen.

Megjithatë, gjatë operimit, kompania duhet të marrë masat e mëposhtme për mbrojtjen e ajrit:

- Mirëmbajtja e rregullt dhe pastrimi i hapësirave të fabrikës, si brenda ashtu edhe jashtë saj.
- Mirëmbajtja periodike e të gjithë makinerive të punës dhe makinerive lëvizëse-motorike, për të garantuar funksionimin efikas dhe të sigurt pa ndotur ajrin.
- Vendosja dhe funksionimi i sistemit të ventilimit në të gjitha hapësirat e brendshme të fabrikës, për të siguruar qarkullimin e ajrit dhe për të parandaluar koncentrimin e substancave të mundshme ndotëse.

Gjithashtu, mbetjet e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të punës duhet të grumbullohen në kontejnerët e dedikuar të mbeturinave, të cilat pastaj menaxhohen nga kompania e kontraktuar për pastrim dhe menaxhim të mbeturinave.

6.2. Masat për mbrojtjen e tokës dhe ujit

Në funksion të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç u përmend më sipër, nga ky aktivitet nuk priten ndikime të konsiderueshme në truall. Kjo sepse pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës ku operon fabrika është e mbuluar me beton, duke ulur ndjeshëm rrezikun e ndotjes direkte të tokës.

Ndotja potenciale e ujit mund të vijë nga:

- Proceset e larjes së hapësirave të brendshme të fabrikës;
- Larja e pajisjeve të përdorura në procesin teknologjik.

Megjithatë, aktualisht fabrika nuk i grumbullon në mënyrë adekuate këto ujëra të ndotura, por i shkarkon direkt në mjedis, gjë që paraqet rrezik për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Rekomandime për minimizimin e ndikimeve:

- Ndërtimi i baseneve dhe impianteve për trajtimin e ujërave industriale, në mënyrë që të sigurohet trajtimi adekuat para shkarkimit në mjedis.

- Sigurimi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave industriale, duke përfshirë mbledhjen e ujërave të shkarkuar nga të gjitha objektet e fabrikës dhe dërgimin e tyre në impiant për trajtim para shkarkimit final.
- Investitori duhet të zbatojë në mënyrë rigorozë të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe burimeve të tjera ujore.
- Gjatë funksionimit të fabrikës, pronari duhet të kryejë matje periodike të cilësisë së ujërave të shkarkuara; vlerat e matjeve duhet të krahasohen dhe nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Vlerat Kufizuese të Efluentit që Shkarkohet në Trup Ujor dhe në Rrjetin e Kanalizimit Publik (nr. 13/2008), si dhe në normat e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.
- Rezultatet e matjeve dorëzohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Intervali i matjeve përcaktohet sipas aktit ligjor dhe marrëveshjes me Ministrinë përkatëse.



Fig 5. Skema teknologjike e trajtimit të ujërave

Madhësia dhe dimensionimi i separatorit caktohen në bazë të sasisë së ujërave që duhet trajtuar apo në bazë të numrit të cikleve për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim, në rastin konkret preferohet separatori me kapacitet 3 l/sec.

6.4. Masat për mbrojtje nga zhurma

Fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, nuk shkakton zhurmë të madhe, përveç një niveli të ulët zhurme, i cili është brenda kufijve të lejuar.

Lokacioni ku ushtron aktivitetin kjo fabrikë gjendet afër rrugës tranzite Prizren – Suharekë, prandaj zhurma që krijohet nga impianti për prodhimin e sapunit, detergjentëve dhe produkteve të tjera është më e vogël sesa ajo e shkaktuar nga komunikacioni, dhe si e tillë nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh për mjedisin përreth.

Megjithatë, operatori ekonomik duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nënligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës brenda normave të lejuara, duke përfshirë:

- Kontrollimin e rregullt të pajisjeve dhe impianteve që prodhojnë zhurmë;
- Shkurtimin në maksimum të kohës së mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike;
- Mirëmbajtjen e rregullt të të gjitha pajisjeve dhe makinerive që emetojnë zhurmë gjatë procesit të punës;
- Zbatimin e masave teknike dhe organizative për uljen e niveleve të zhurmës, kurdoherë që është e nevojshme.

6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Lokacioni ku është e vendosur fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, siç është cekur edhe më lart, është mjaft i përshtatshëm për këtë lloj veprimtarie, ngase gjendet pranë zonës industriale dhe afër rrugës rajonale Prizren – Suharekë. Duke pasur parasysh që kjo zonë tashmë është shndërruar në një zonë industriale, ndikimet në florë dhe faunë janë realizuar më herët gjatë zhvillimeve infrastrukturore.

Bazuar në të gjitha këto fakte, si dhe natyrën e aktivitetit të kompanisë, nuk pritet që të ketë ndikime negative shtesë në peizazh, florë dhe faunën e vendbanimit në fjalë dhe të rajonit në përgjithësi.

6.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj fabrika për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim janë një numër i konsiderueshme i objekteve industriale. Ndërsa, shtëpi banim afër fabrikës nuk kemi, vendbanim ndodhen me një distance mjaftë të konsiderueshëm nga shtëpitë e banimit.

6.7. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Aksidentet që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të fabrikës për prodhimin e detergjentëve vlerësohen si raste të izoluara. Megjithatë, për të parandaluar çdo aksident eventual, investitori i fabrikës duhet të marrë të gjitha masat adekuate paraprakisht.

Burimet potenciale të aksidenteve:

- Energjia elektrike dhe pajisjet elektrike të fabrikës
- Substancat kimike që përdoren në procesin e prodhimit të detergjentëve

Masat parandaluese të rekomanduara:

Siguria nga zjarri dhe emergjencat:

- Të instalohen hidrantët me pajisjet përcjellëse dhe aparatet plotësuese kundër zjarrit në hapësirat e fabrikës.
- Të ndërtohet dhe mirëmbahen sistemi i pajisjeve kundër zjarrit, duke përfshirë:
 - Mjete shuarëse me ujë
 - Mjete shuarëse kimike adekuate për llojin e substancave që përdoren

Siguria në punë:

- Të merren të gjitha masat e sigurisë konform Ligjit për Siguri në Punë, për mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.
- Të hartohet Rregullorja e sigurisë, ku të definojnë qartë:
 - Procedurat për rastet aksidentale
 - Aftësimi i punëtorëve për menaxhimin e emergjencave
 - Caktimi i detyrave dhe përgjegjësi të secilit punëtor në situata aksidentale

Planet operative të detyrueshme:

- Të hartohet Plani i intervenimit për rastet e aksidentave mjedisore.
- Të përgatitet Plani i mbrojtjes nga zjarri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi i mbeturinave:

- Ambienti i kompleksit të fabrikës duhet të mirëmbahet në mënyrë permanente.
- Pronari i fabrikës është i detyruar të mbajë evidencën dhe ruajë shënimet për:
 - Dërgimin e mbeturinave në qendrat e licencuara për riciklim.

- Sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara dhe mbeturinave të tjera, për të vërtetuar daljen e tyre nga lokacioni (vendi për grumbullimin e mbeturinave).
- Evidenca dhe shënimet mbahen në përputhje me:
 - Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturina
 - Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina
 - Udhëzimet administrative për mbeturina të hartuara sipas këtyre ligjeve

6.8. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim, mbeturinat që krijohen gjatë procesit të punës duhet të mblidhen dhe të trajtohen sipas nevojës përpara se të hidhen në kontejnerët e mbeturinave.

Llojet e mbeturinave:

Mbeturinat ditore, të krijuara nga personeli gjatë orarit të punës

Mbetjet industriale, të mbetura nga proceset teknologjike dhe pastrimi i pajisjeve

Produkte të skaduara dhe substanca kimike të papërdorura

Masat për menaxhimin e mbeturinave:

Grumbullimi dhe depozitimi:

- Të gjitha mbeturinat ditore që krijohen nga personeli do të grumbullohen dhe do të hidhen në mënyrë adekuate në kontejnerët e vendosur nga ndërmarrja komunale për menaxhimin e mbeturinave.
- Mbetjet e tjera industriale do të merren nga kompania e kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave, me të cilën fabrika ka marrëveshje zyrtare.

Produktet e skaduara dhe substancat kimike që nuk përdoren duhet:

- Fillimisht të kontrollohen dhe të inspektohen nga Inspektorati kompetent.

- Pas verifikimit, të dërgohen për asgjësim të sigurt sipas procedurave dhe legjislacionit në fuqi.

Menaxhimi i mbeturinave duhet të kryhet në përputhje me:

- Ligjin Nr. 02/L-30 për Mbeturina
- Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina
- Udhëzimet administrative për mbeturina të hartuara sipas këtyre ligjeve.

Të gjitha praktikatat e menaxhimit të mbeturinave duhet të synojnë eliminimin e ndikimeve negative mjedisore dhe ruajtjen e shëndetit publik.

7.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Pas përfundimit të jetëgjatësisë së projektit të fabrikës për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, si dhe pallomave të terura, i cili varet nga vendimi i pronarit, në rast se vendoset të mos vazhdohet më tej me këtë aktivitet, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

Të gjitha objektet ekzistuese do të largohen plotësisht nga lokacioni.

Bazamentet dhe platot e betonit do të shkatërrohen, do të imtësohen dhe materiali do të transportohet për deponim në deponinë rajonale të licencuar, sipas legjislacionit për mbeturina inerte. Të gjitha mbeturinat e mbetura, të çdo lloji, do të largohen nga lokacioni.

Shtresat e dheut të kontaminuar, nëse ekzistojnë, do të hiqen plotësisht dhe do të zëvendësohen me një shtresë humusi me trashësi 0.5 m, e cila duhet të analizohet paraprakisht nga aspekti agrokimik, për të garantuar përshtatshmërinë për rikultivim. Pas vendosjes së shtresës së re të humusit, duhet të kryhet ngjeshja për të krijuar një substrat kompakt dhe produktiv.

Rikultivimi i sipërfaqeve të dëmtuara ka për qëllim: Rivitalizimin e plotë të zonës së prekur nga aktiviteti industrial, kthimin e funksionit primar të tokës, përmes rikthimit të saj në gjendje sa më të afërt me ambientin përreth, mbjelljen e kulturave bujqësore periodike, që kultivohen në zonën përreth, për të promovuar prodhimin e biomasës dhe për të zvogëluar ndikimin negativ të projektit në ekosistem.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit do të varet nga: Qëllimi i rikultivimit (p.sh. përdorimi bujqësor, peizazhor apo rekreativ) dhe karakteristikat e truallit dhe nevojat e komunitetit local.

8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Investitori është i obliguar që të bëjë monitorimin e përhershëm të ndikimeve negative në mjedis e posaçërisht monitorimin e ujerave të cilat derdhën nga hapësirat e fabrikës për prodhim të sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim dhe nga infrastruktura përcjellëse. Monitorimi i ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, për të vërtetuar nivelin e pastërtisë së ujërave që shkarkohen nga hapësirat e operacionale. Të bëhet kontrollimi i përhershëm i seperatorve si dhe i gropës septike, dhe zbrazja e tyre të bëhet me kohë. Kontejnerët e mbeturinave të zbrazën rregullisht. Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

9.0 KONKLUZIONE DHE PËRFUNDIM

Duke analizuar studimin e kryer për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masat për parandalimin e tyre, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese, mund të konkludojmë si më poshtë:

Fabrika për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim, e vendosur në zonën kadastrale Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, paraqet këtë projekt:

- Në interes të investitorit, duke mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të biznesit të tij;
- Në interes të Komunës së Prizrenit dhe më gjerë, duke siguruar furnizim me detergjentë vendorë dhe cilësorë;
- Me ndikim pozitiv në rritjen e punësimit dhe të hyrave në nivel lokal dhe kombëtar.

Kompania “SHINY 1” SH.P.K., me fabrikën për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit nuk paraqet potencial për rrezikimin e shëndetit të njerëzve. Gjithashtu, ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, mund të zvogëlohen në nivel të pranueshëm.

Po ashtu, fabrika do të ketë ndikime pozitive në përmirësimin e mjedisit dhe aspekteve socio-ekonomike, për shkak të punësimit të stafit lokal dhe zhvillimit ekonomik.

Bazuar në të dhënat e prezantuara, vlerësojmë se informacionet e ofruara janë të mjaftueshme për raportin e VNM-së dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhënien e mendimit pozitiv për pëlqimin mjedisor për Kompaninë “SHINY 1” SH.P.K., me seli në Prizren dhe pronar z. Adnan Bylbyli.

LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Prizrenit
2. Harta zonale e komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House Prishtinë.
6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
8. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,
10. Mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.
11. Të dhënat nga ëeb faqja e Komunës së Prizrenit.

Shtojcë

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Te dhënat për biznesin,
- Certifikatat e pronës,
- Kopjet e planit,
- Situacioni i terenit
- Njoftimi komunal/PZHK-se së Prizrenit

PËRSHKRIMI I VLERËS INVESTIVE

PËR PROJEKTIN ME TITULL: Fabrikë për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura.

ZONA KADASTRALE; Lubizhdë KOMUNA Prizren

PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR; Kompania “SHINY 1” SH.P.K.

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Linje e Prodhimit	
2.	Makine për mbushje/paketim	
3.	Makinë për vendosjen e kapakut	
4.	Makinë për vendosjen e etiketës	
5.	Objekti i fabrikës	
Shuma totali investive:		

Aplikuesi i projektit:

z. Adnan Bylbyli, drejtor i kompanisë

_____ **v.v.**

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës			
Data e aplikimit			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	Fabrikë për prodhimin e sapunit, detergjentëve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim, si dhe pallomave të terura		
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	€		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,		Po	Jo
	1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-së (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).	X	
	2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore	X	
	3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit	X	
	4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).	X	
	5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref	X	
	6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar	X	
	7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor		
	8. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;	X	
	9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit	X	
	10. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive : Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve		
	11. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.	X	
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	z. Adnan Bylbyli		
Kompania	“SHINY 1” Shpk		
Adresa e Kompanisë	Rruga. Ukë Bytyqi p.n. Prizren		
Tel, fax, E-maili	+383 44 614 891 infoshinycleaners@gmail.com		